



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1301/ 11 prot.,

Datë 16.06.2025

V E N D I M

Nr. 781/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga,

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me

- Objekt:** Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. 765/2025, datë 11.06.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë
- Kërkuesi:** Operatori ekonomik “Muca” shpk me NIPT K01421002H dhe me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km.13, fshati Picar.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, dëgjoi relatorin e çështjes, e pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 23.04.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

I.2. Në datën 21.05.2025, përsëri, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5330 dhe me numer 1301-1/2025 prot, datë 21.05.2025 e operatorit ekonomik “Muca” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Zdrava” 07 SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Muca” shpk kërkon ndryshimin e vendimit të KVO mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së OE Fral 2000 shpk duke e lënë sërish të skualifikuar për arsye të tjera.

I.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1301/2 prot., datë 22.05.2025, lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Zdrava” 07 SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1301-1/2025 prot., datë 21.05.2025. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimuesit, që të ndryshojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Fral 2000” SHPK, për mospërbushjen e kriterit 2.3.2 dhe plotësimit të disa rubrikave të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ana e këtij ofertuesi, duke e lënë sërish të skualifikuar.

I.4. Me shkresën përcjellëse me nr.1666/4 prot., datë 29.05.2025, protokolluar me tonë me nr. 1301/4 prot., datë 02.06.2025, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar, shoqëruar me dokumentacion mbështetës, ku ka **pranuar pjesërisht** pretendimet e subjektit ankimues.

I.5. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet lidhur me arsyet e skaulifikimit për subjektin “Fral-2000” shpk, si më poshtë: “...[“Fral-2000” shpk ka plotësuar pjesërisht saktë shtojcën 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhëna të nevojshme për disa prej rubrikave dhe jo për të gjitha, sic ky formular parashikon, pretendimi ankimesit **pranohet pjesërisht**.”

-KSHA gjykon se, OE “Fral-2000” shpk me dokumentacionin e dorëzuar nuk plotëson kriterin 2.3.2 të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. pretendimi ankimesit **pranohet** ”.

I.6. Në datën 11.06.2025 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 765/2025, ka vendosur:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “Muca” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.7. Në datën 13.06.2025 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1301/9 prot., datë 13.06.2025, shkresa e operatorit ekonomik “Muca” SHPK me objekt: “Kërkesë” mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muca” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a”, me anë të së cilës kërkon si vijon:

“...[Shogëria “Muca” shpk ka bërë ankesën A/2025/5330 dhe me nr. 1301-1, datë 21.05.2025, pranë KPP_së dhe njëkohësisht pranë AK, për procedurën “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, me Nr. REF-45761-04-22-2025, zhvilluar nga enti prokurues, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Pas shqyrtimit të anksës nga KSHA-ja e AK, nga ana e këtij të fundit, ankesa jonë është pranuar pjesërisht.

KPP njëzëri vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor.
3.

4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “Muca” SHPK.

5.

6.

Në këto kushte, mendojmë se, tek dispozitivi i vendimit të KPP-së nr. 765/2025 datë 11.06.2025, është bërë pa dashje lapsus. Kërkojmë korigjimin e dispozitivit të vendimit të mësipërcituar të KPP-së”...].

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP, i ndryshuar)

II.1.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK, për rishikimin e vendimit të KPP-së nr. 765/2025 date 11.06.2025, KPP nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj dhe argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit, kjo në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 24/1 i LPP, i ndryshuar).

II.1.2. KPP, gjen me vend të theksojë gjithashtu se ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. KPP në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse.

Akoma më tej, në respekt të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe përkatësisht në nenin 121 të tij, ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik kanë cënuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 24/1 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri;

Vendos:

1. Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK për rishikimin e vendimit të KPP-së nr. 765/2025 datë 11.06.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fioorent Zguro

